



Pranuar / Dorezuar Prijemno / Predato Received / Delivered	08 - 09	2023	3	viti god year
Organ / Shënia Organ / Jednica Org / Unit	SKRIPSHICK	6016/2023		114
Numri i Prot. In Prot. Prot. No.				
Shtesa Prilog Appendix				
Sasia Kolicina Quantity				



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.1047/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga: Arben Mehmeti-kryetar, Eshref Shabani dhe Ardita Haxhnikaj-Demi-anëtarë dhe Avdyl Bekteshi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, kanë shqyrtuar ankesën A.nr.1047/2023 të datës 31.07.2023 të parashtruar nga ankuesi me adresë rruga kundër Vendimit Nr. 15/2023 të datës 14.06.2023 të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë në Ministrinë e Punëve të Brendshme, në çështjen juridike "kontestim konkursi", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 08.09.2023, mori këtë:

V E N D I M

Hedhet poshtë si e palejuar ankesa me numër A.nr.1047/2023 e datës 31.07.2023 e parashtruar nga ankuesi

A r s y e t i m

Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë në Ministrinë e Punëve të Brendshme më datë 06.04.2023 ka njoftuar për shpalljen e konkursit me Nr.Reference: RN00011404 për grupin Specialistë të Përgjithshëm të Shkencave Politike respektivisht për pozitën "Zyrtar i Misionit Diplomatik", ku afati për aplikim ka qenë nga data 27.04.2023 deri më datë 06.05.2023.

Në këtë konkurs ka aplikuar edhe ankuesi, ku përmes Vendimit me Nr.05/2023 të datës 05.06.2023 të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë në Ministrinë e Punëve të Brendshme i është refuzuar aplikacioni me arsyetimin se nuk ka ofruar dëshmi me afat të dëshmisë mjekësore, zotësisë për të vepruar dhe nuk ka ofruar dëshmi të përgatitjes profesionale diplomë të arsimimit të lartë më së paku 3 vite të studimeve në Shkenca Politike/ Administratë Publikë/Politika Sociale/Juridik.

Kundër këtij vendimi, ankuesi ka parashtruar ankesë në Departamentin për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë në Ministrinë e Punëve të Brendshme, ndërsa Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë në Ministrinë e Punëve të Brendshme me Vendimin me Nr. 15/2023 të datës 14.06.2023 ka aprovuar pjesërisht ankesën e ankuesit duke e marr për bazë pretendimin e ankuesit sa i përket dëshmisë për zotësi për të vepruar dhe dëshmi sa i përket gjendjes shëndetësore ndërsa ka refuzuar aplikacionin për shkak që nuk ka ofruar dëshmi të përgatitjes profesionale.

Ankuesi kundër Vendimit me Nr.15/2023 të datës 14.06.2023 të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë në Ministrinë e Punëve të Brendshme, vendim të cilit ankuesit i është dërguar me email përmes Sistemit për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore më datë 14.06.2023, më datë 31.07.2023 përmes emailit ankesa.kpmshck@rks-gov.net ka parashtruar ankesë më numër protokolli 5462/2023 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datën 03.08.2023 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë te Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë. Ndërsa Këshilli me datë 17.08.2023, ka pranuar përgjigjen në ankesë se bashku me shkresat lidhur me çështjen në procedurë.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave me rastin e shqyrtimit të kësaj ankesë ka administruar këto prova: Ankesa e ankuesit me numër protokolli 5462/2023 të datës 31.07.2023 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; CV-në e ankuesit; Konkursin me Nr.Referenc: RN00011404 për grupin Specialistë të Përgjithshëm të Shkencave Proklitike respektivisht për pozitën *Zyrtar i Misionit Diplomatik*; Vendimin me Nr.15/2023 të datës 14.06.2023 të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë në Ministrinë e Punëve të Brendshme; Njoftimin për refuzim të aplikacioni i datës 14.06.2023 për ankuesin nga SIMBNJ; Dëshmi për dërgimin e Vendimit me Nr.15/2023 të datës 14.06.2023 të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë në Ministrinë e Punëve të Brendshme; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 03.08.2023; Përgjigjen në ankesë e datës 17.08.2023; Vendimin me Nr. 05/142 të datës 10.05.2023 për emërimin e Komisionit të Pranimit; Listën e aplikantëve; Njoftimin e datës 05.06.2023 dhe 14.06.2023; Vendimin me Nr.05/2023 të datës 05.06.2023 të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë në Ministrinë e Punëve të Brendshme; Ankesën e ankuesit e datës 07.06.2023; Njoftimin e datës 30.06.2023; Listën e aplikantëve të aprovuar dhe refuzuar; Aplikacionin e ankuesit i datës 06.05.2023; Diplomën e datës 18.06.2011 për kryerjen e shkollës së mesme të lartë; Diplomë e Bachelor në STAFFORDSHIRE UNIVERSITY e datës 26/06/2014; Emailin e datës 19.19.2922 nga NARIC për ankuesin; Diplomë e studimeve master; Vendimin Ref. Nr.216/3219 i datës 24.08.2022; Certifikatën me Nr. KBA 004/2014; Certifikatën për periudhën 01-05.12.2017; Certifikatën 2016; Pasqyrën e llogarisë nga Trusti për periudhën 02.01.2017-30.05.2023; Letër Rekomandimin e datës 09.11.2020; Letër Referencë e datës 22.09.2020; Dokument identifikimi i ankuesit; Certifikatën mbi dënimet penale e datës 06.05.2023; Vërtetimin me Nr. 05.711-1-406 të datës 26.07.2022; Certifikatën shëndetësore e datës 26.07.2022.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, duke shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët, ka konstatuar se ankesa e ankuesit, është e palejuar, sepse:

Kolegji i Këshillit, në bazë të provave të lëndës, konstaton se Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë në Ministrinë e Punëve të Brendshme, më datë 14.06.2023 ka nxjerr Vendim me Nr. 15/2023 me të cilin ka aprovuar pjesërisht, ankesën e ankuesit të parashtruar kundër Vendimit me Nr. 05/2023 të datës 05.06.2023, me të cilin vendim ankuesi përmes emailit Sistemit për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore është njoftuar më datë 14.06.2023 të cilën provë materiale e ka dërguar ankuesi.

Kolegji i Këshillit, lidhur me pranueshmërinë e ankesës së ankuesit, konstaton se sipas nenit 125 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, është përcaktuar se: *“Përpos nëse është paraparë ndryshe me ligj, ankesa mund të parashtrohet kundër një akti administrativ apo ndaj mosveprimit të organit publik brenda afatit të përcaktuar për përfundimin e procedurës administrative (në vijim: “heshtja administrative”)*”, si rrjedhojë ankuesi ankesën në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës e parashtruar kundër Vendimit me Nr.15/2023 të datës 14.06.2023 të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë në Ministrinë e Punëve të Brendshme.

Duke marr parasysh afatin për parashtrimin e ankesës ndaj aktit administrativ, Kolegji i Këshillit, ju referua nenit 127 paragrafin 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, i cili shprehimisht përcakton: *“Ankesa duhet të parashtrohet brenda tridhjetë (30) ditëve, nga data kur është njoftuar për aktin administrativ”*, si rrjedhojë meqenëse ankuesi vendimin e kundërshtuar me këtë ankesë e ka pranuar përmes emailit më datë 14.06.2023, ndërsa ankesën në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës e ka parashtruar më datë 31.07.2023, mbi këtë bazë Kolegji i Këshillit, konstaton se ankesa e ankuesit e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës është parashtruar në kundërshtim me afatin e përcaktuar si më lartë, nga kjo rrjedh se ankesa e ankuesit është e pasafatshme dhe si e tillë është e palejuar në kuptim të nenit 129 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Andaj, nisur nga konstatimet si me lartë, Kolegji në mbështetje të nenit 129 paragrafin 1 nën paragrafin 1.3 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative si dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda, A.nr.1047/2023, datë 08/09/2023

Avdyl BEKTESHI

Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional

Arben MEHMETI

Kryetar i Kolegjit



Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit,
- Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë në Ministrinë e Punëve të Brendshme; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

